



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERCJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIJË DHE ENERCJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË

Nr. 9021/Prot.

Tiranë, më 05.12.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1496/2, datë 10.07.2013.

SHOQËRISË “BALKAN MINERAL INVEST” SH.P.K

Rruga "Ismail Qemali", Pall. 7/1, Shk. 2, Ap. 10, Tiranë.

Për dajeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Balkan Mineral Invest” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1496/2, datë 10.07.2013, për mineralin rërë bituminoze, në Objektivin “Treblovë, Romes”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.2672/2, datë 21.11.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.9021, Prot, datë 23.11.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1496/2, datë 10.07.2013, për mineralin rërë bituminoze, në Objektivin “Treblovë, Romes”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjisllacionit minierar, ku nga kontrolli në objekt u konstatua se subjekti nuk ka zhvilluar aktivitet minierar për më shumë se 180 ditë dhe nuk ka paguar garancinë financiare të rehabilitimit për vitin 2022.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “b” (ii) dhe pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1496/2, datë 10.07.2013, për mineralin rërë bituminoze, në Objektivin “Treblovë, Romes”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1496/2, datë 10.07.2013, për mineralin rërë bituminoze, në Objektivin "Treblovë, Romes", Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të Ligjit Nr. 10/304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTA

